




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS  
KESHILLI BASHKIAK**



Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Vau Dejes, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2022

**VENDIM**

**Nr. 81 Date : 30/11/2022**

**PËR**

**“Miratimin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor me procedurë të thjeshtuar”**

Në mbështetje të ligjit 139/2015 dt. 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, ndryshuar të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 për “Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” (i ndryshuar); Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 për “Miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” (i ndryshuar); si dhe në Vendim nr.3 KKT dt 27.04.2018 "Për Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Vau Dejës" . në VKM Nr.686, datë 22.11.2017 “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit” si dhe në zbatim të *Vendimit të Kryetarit nr.13 date 06.04.2020*.

Në dokumenta: *Rishikimit i PPV Vau Dejes me procedurë të thjeshtuar*, Akti i përputhmerisë së leshuar nga AKPT date nr. 1444/01 date 20.10.2022, Deklarata mjedisore nga ing. I licensuar mjedisor, si dhe në Projekt – Vendimin e hartuar nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Investimeve Publike për “Miratimin e Rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor me procedurë të thjeshtuar”, miratuar nga Kryetari i Bashkisë Vau Dejes:

**Këshilli Bashkiak, pas diskutimit dhe miratimit me shumicë të votave,**

**VENDOSI**

Te miratojë **“Projekt – Vendimin të Rishikimit të planit të përgjithshëm vendor me procedurë të thjeshtuar”**.

Për zbatimin e kësaj rregullore janë të ngarkuara:

- Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Investimeve Publike,
- Drejtoria e Zhvillimit Rural , Turizmit, Mbrojtjes së Mjedisit dhe Konsumatorit, “Sektori Menxhimit të Pyjeve dhe Kullotave”.
- Ky vendim i njoftohet Prefektit të Qarkut Shkoder.

- Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 të ligjit 139/2015 date 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”(ndryshuar)
- Ky Vendim u shpall sot me datë 05/12/2022.



**SEKRETAR**

**ARDIAN ÇELEPIJA**

**KRYETAR**

**MARK BISHA**

Miratur me 19 vota

Vota pro 19

Vota kunder -

Vota abstenim -

Zbardhur me date 05/12/2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Pr. 6833/1 Prot

Df. 12.12.22

Nr.897/1.prot.

Shkodër, më 12.12.2022



Lënda: Mbi vendimin nr. 81, datë 30.11.2022 të Këshillit Bashkiak Vau-Dejës.

**KËSHILLIT BASHKIAK VAU-DEJES**



Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107, datë. 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", Urdhërit të MB nr.175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", Urdhërit të Kryeministrit Nr.50 datë.12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit Qarkut Shkodër", ligjit Nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 23 pika 14, neni 54/n, neni 64 shkronja "c", ligjit Nr.107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit në RSH" i ndryshuar, neni 12, pika 2, shkronja a, neni 26/2, VKM Nr.686 date.22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit" i ndryshuar, neni 11, neni 44 të ligjit Nr.20/20 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH", ligjit Nr.111/2012 "Për menxhimin e burimeve ujore" i ndryshuar, Shkresës së Agjensisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit Nr.1444/01prot datë.28.10.2022 "Akt përputhshmërie për dokumentin e rishikimit të planit të përgjithshëm vendore të Bashkisë Vau-Dejës", Shkresës të Sekretarit të Këshillit të Bashkiak Malësi e Madhe Nr.6827.prot datë.5.12.2022 "Bashkëlidhur ju dërgojmë dokumentacionin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau-Dejës të datës.30.11.2022".

*Shqyrtoi VKB Vau-Dejës nr.81 datë.30.11.2022 "Mbi rishikimin e planit të përgjithshëm vendore të Bashkisë Vau-Dejës, miratuar me vendimin e KKT-së Nr.3 datë.27.04. 2018".*

Për sa trajtuar, referuar akteve ligjore/nënligjore të sipërcituara, Prefekti ju autorizon procedim të mëtejshëm.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**P R E F E K T I**

**Majlinda ANGONI**

